

VENDIM
Nr.762, datë 1.9.2010

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË RINOVUAR, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
SHOQËRISË “MICROSOFT CORPORATION”, PËR PROJEKTIN E
PARTNERITETIT STRATEGJIK NË FUSHËN E TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT**

(Ndryshuar me Vendimin nr. 174, datë 2.3.2011)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17, 23 e 27 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së rinovuar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Microsoft Corporation”, për projektin e partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit.

2. Kostot financiare për realizimin e projektit strategjik, në fushën e teknologjisë së informacionit, sipas marrëveshjeve të veçanta, mbulohen nga Buxheti i Shtetit, sipas fondeve respektive të institucioneve, përkatësisht:

a) Për grupmarrëveshjet e institucioneve qendrore dhe për marrëveshjen e Forcave të Armatosura, nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);

b) Për marrëveshjen e arsimit universitar “Campus Agreement” nga AKSHI;

c) Për marrëveshjen e shërbimeve të konsulencës dhe mirëmbajtjes nga AKSHI;

ç) Shfuqizuar;

d) Për marrëveshjen e sistemit gjyqësor nga AKSHI.

3. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit kryen pagesën prej 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, si pjesë e fondit të përgjithshëm prej 950 000 000 (nëntëqind e pesëdhjetë milionë) lekësh, për mbulimin e kostove financiare të vitit të parë të kësaj marrëveshjeje (qershor 2010-qershor 2011).

4. Fondi i përcaktuar për pagesë në pikën 3 të këtij vendimi, do të përballohet si më poshtë vijon:

a) 48 000 000 (dyzet e tetë milionë) lekë, nga shpenzimet korrente të miratuara për buxhetin e vitit 2010, të programit “Shërbime për shoqëritë e informacionit”, në grupin “Institucione të tjera qeveritare”.

b) Programit “Shërbime për shoqëritë e informacionit”, në grupin “Institucione të tjera qeveritare” në kategorinë shpenzime korrente, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi prej 222 000 000 (dyqind e njëzet e dy milionë) lekësh, i cili do të përballohet:

i) 22 900 000 (njëzet e dy milionë e nëntëqind mijë) lekë, nga fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit;

ii) 199 100 000 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e njëqind mijë) lekë, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Ministri i Financave, Ministri i Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

E PARTNERITETIT STRATEGJIK

Kjo marrëveshje e partneritetit strategjik, e cila mbulon bashkëpunimin në fushën e teknologjisë së informacionit (Marrëveshja), është lidhur dhe nënshkruar më 15.6.2010, ndërmjet:

1. Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga z.Genc Pollo, Ministër i Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (Qeveria).

2. “Microsoft Albania” sh.p.k., rruga: “Abdyl Frashëri”, P.11/1 EGT Tower, kati II, 1000 Tiranë, Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Arsen Kurti, menaxher vendor, Microsoft Albania (Microsoft).

DEKLARIME

Duke marrë në konsideratë se qeveria ka vendosur:

- Të përdorë softuerë të licencuar rregullisht të teknologjisë më të fundit, në të gjitha nivelet e administratës publike dhe në arsim, si dhe të rrisë sigurinë dhe transparencën e përdorimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikacionit (ICT) në administratën publike;

- Të stimulojë industrinë vendase të ICT-së dhe të nxisë zhvillimin e njohurive mbi ICT-në nga popullata e Republikës së Shqipërisë (Republika), si dhe aftësimin e tyre në lidhje me të;

- Të garantojë zbatueshmërinë e të drejtave mbi pronësinë intelektuale sipas standardeve të BE-së dhe udhëzimeve të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), si dhe zbatimin e plotë dhe efektiv të ligjeve të zbatueshme të Republikës;

- Të rezervojë të drejtën, sipas gjykimit të vet, për të blerë produkte softueri dhe/ose shërbime nga ofrues të tjerë, që nuk janë pjesë e Microsoft.

Duke marrë në konsideratë se Microsoft dhe filialet e tij, në mbështetje të përpjekjeve të qeverive kombëtare, ka zhvilluar një numër programesh të zgjeruara, të cilët promovojnë ICT-në në administratën publike dhe institucionet arsimore, si dhe në komunitetin e biznesit, dhe dëshiron që këto programe t'i zbatojë më tej në Republikë;

Duke marrë në konsideratë se qeveria i bëri të ditur Microsoft-it se për të arritur qëllimet e politikës së ICT-së, do të ishte në interes të qeverisë të përfitonte nga Microsoft

dhe filialet e tij një paketë fleksibël me kombinime të produkteve dhe/ose shërbimeve të Microsoft Corporation, të cilat do të përdoren nga qeveria;

Duke marrë në konsideratë se palët dëshirojnë të përfshihen në përpjekje të përbashkëta, përfshirë, por jo kufizuar në i) përmirësimin e përdorimit të ICT-së në sektorët e administratës publike, arsimit dhe komunitetit të biznesit në Republikë, ii) promovimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike, iii) krijimin e kuadrit të përgjithshëm kontraktual për licencimin e produkteve softuer të Microsoft Corporation dhe shërbimeve për administratën publike dhe sektorin arsimor në Republikë, dhe iv) marrëveshjen mbi shërbimet dhe/ose produktet e veçanta që do të ofrohen nga Microsoft dhe filialet e tij për qeverinë, në mënyrë që qeveria të arrijë objektivat për politikën e saj të ICT-së,

rrjedhimisht, palët bien dakord për sa më poshtë:

1. PËRKUFIZIME

Palët bien dakord që termat e përdorur në këtë marrëveshje të kenë kuptimet e mëposhtme:

1.1 “Republika e Shqipërisë” është i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, si dhe të gjitha zyrat e përfaqësive diplomatike dhe konsullore që përfaqësojnë interesat e saj.

1.2 “Marrëveshje për kampuset dhe shkollat” është marrëveshja e Microsoft për kampuset dhe shkollat, ndërmjet MIOL dhe qeverisë. Marrëveshja për kampuset dhe shkollat është një program licencimi-abonimi i krijuar posaçërisht për të trajtuar nevojat e veçanta të shkollave nëntëvjeçare dhe të mesme, si dhe të institucioneve të arsimit të lartë.

1.3 “Partnerë të certifikuar” janë shoqëritë e pavarura, të regjistruara në programin e Microsoft-it të partnerëve të certifikuar. Partnerët e certifikuar u ofrojnë klientëve të tyre teknologji të avancuar të informacionit dhe komunikimit, nëpërmjet konsultimit, shpërndarjes, mirëmbajtjes në distancë dhe në vend, mbështetje nga qendrat e asistencës, aplikim për paketë software, shërbime pritëse dhe trajnime.

1.4 “Marrëveshja e shoqërisë” është marrëveshja e shoqërisë e Microsoft-it e lidhur ndërmjet MIOL dhe qeverisë. Marrëveshja e shoqërisë do të zbatohet nga partnerët lokalë të MIOL (Rishitësit e mëdhenj të Microsoft-it) nëpërmjet marrëveshjeve të tyre të veçanta me qeverinë.

Marrëveshja e shoqërisë është një marrëveshje për një vëllim softuerë-sh të licencuar, e hartuar për shoqëri ose klientë publikë, ku përfshihen 250 ose më shumë kompjuterë.

1.5 “RMM-të” ose “Rishitësit e mëdhenj të Microsoft-it”, të cilët MIOL i autorizon për shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve të Microsoft te përdoruesi fundor në Republikë sipas marrëveshjes së shoqërisë. Sipas këtij autorizimi, qeveria do të lidhë marrëveshje të veçanta me RMM-të për shpërndarjen e software-ve.

1.6 “Marrëveshja e biznesit dhe shërbimeve e Microsoft” është marrëveshja e biznesit dhe shërbimeve e lidhur ndërmjet MIOL dhe qeverisë. Marrëveshja e biznesit dhe e shërbimeve e Microsoft rregullon kushtet kryesore të biznesit dhe ato ligjore të cilat janë të përbashkëta me marrëveshjen e shoqërisë dhe deklarin e shërbimeve të Microsoft-it.

1.7 “Deklarimi i shërbimeve të Microsoft” është përshkrimi kryesor i shërbimeve të Microsoft-it, sipas të cilit klientëve fundorë iu ofrohet asistencë në përdorimin e tyre të infrastrukturës së ICT-së, shërbime nga teknikë profesionistë të përkushtuar, të cilët mbikëqyrin nevojat që kanë klientët për asistencë, duke ofruar asistencë në zgjidhjen e problemeve dhe disponueshmëri ndaj klientëve sipas një sistemi 24 orësh dhe 7 ditë në javë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes, trajnime dhe takime pune që mbajnë të

përditësuar stafin e ICT të klientit, mbi teknologjitë më të fundit, si dhe urdhri i punës së Microsoft, kur është e zbatueshme, i cili paraqet termat dhe kushtet specifike të projektit për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të Microsoft-it.

2. OBJEKTI I MARRËVESHJES

2.1 Kuadri i përgjithshëm kontraktual. Kjo marrëveshje përcakton termat dhe kushtet për:

a) Bashkëpunimin ndërmjet palëve për sa i përket përdorimit të teknologjive të Microsoft në të gjithë administratën publike, në institucionet arsimore dhe në institucionet e kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë;

b) Mbështetjen që Microsoft u jep iniciativave dhe programeve të qeverisë në lidhje me ICT-në;

c) Kontributin e Microsoft-it në zhvillimin e ICT-së në sektorin privat vendas.

2.2 Përdorimi i softwarë-ve të licencuar nga qeveria. Në këtë marrëveshje, qeveria bie dakord të bëjë përpjekjet maksimale për të përdorur nëpër organet shtetërore dhe në të gjitha institucionet dhe organizmat qeveritarë, vetëm softuerë të ligjshëm, të licencuar nga Microsoft.

3. INICIATIVAT DHE DETYRIMET E MICROSOFT

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Microsoft do të vendosë në dispozicion të qeverisë fushata mbështetëse dhe nisma të ndërmarra për të stimuluar zhvillimin e industrisë moderne të ICT-së në Republikë, sikurse paraqitet në këtë marrëveshje.

3.1 Mbështetja e Microsoft për sektorin publik

a) Rritja e sigurisë së internetit. Microsoft Albania, së bashku me qeverinë dhe partnerë të tjerë jotregtarë dhe tregtarë, do të marrë iniciativa dhe do të organizojë aktivitete që synojnë rritjen e sigurisë gjatë përdorimit të internetit dhe veçanërisht sigurinë e fëmijëve gjatë përdorimit të tij. Pjesë e këtyre iniciativave do të jetë organizimi i seminareve përgatitore për ekspertë të teknologjisë së informacionit, për punonjësit e qeverisë dhe institucioneve të tjera publike, si dhe për policët dhe mësuesit, për t'iu shpjeguar rëndësinë e sigurisë së internetit dhe për t'i edukuar ata mbi sigurinë e internetit. Qeveria, brenda kompetencave që i lejohen nga rregulloret dhe ligjet përkatëse dhe detyrat e ngarkuara sipas këtyre rregulloreve, do të krijojë kushte të favorshme për përgatitjen e materialeve trajnuese arsimore që Microsoft do të planifikojë për mësuesit, punonjësit e arsimit, policinë, prindërit dhe fëmijët.

b) Program bashkëpunimi për sigurinë. Qeveria mund të marrë pjesë në programin e bashkëpunimit për sigurinë (në vijim i referuar si "PBS"), sipas të cilit qeveritë dhe Microsoft Corporation mund të marrin pjesë në mënyrë të strukturuar në veprimtari bashkëvepruese në fushat e reagimit ndaj problemeve kompjuterike, zvogëlimin e sulmeve kompjuterike dhe dhënien e mbështetjes dhe informacionit për qytetarët e prekur nga sulmi. PBS jep një kuadër për shkëmbim informacioni dhe bashkëpunim me organizatat qeveritare përgjegjëse për infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, zbatimin e ligjit, sigurinë publike dhe arsimin. Pjesëmarrja në PBS rregullohet nga një marrëveshje e veçantë ndërmjet qeverisë dhe Microsoft Corporation.

c) Ekosistemi vendor i softuerë-ve. Microsoft Albania do t'i ofrojë qeverisë pjesëmarrje në nismën për ekosistemin vendor të softuerë-ve, që përfshin angazhimin e politikëbërësve vendas, të drejtuesve të industrisë dhe vendimmarrësve të tjerë kyç në

ngritjen e ekosistemeve vendase të softuerë-ve dhe të kuptuarit e rolit të ekonomisë vendase të softuerë-ve në krijimin e mundësive ekonomike.

d) Lokalizimi i Microsoft Office dhe Microsoft Windows. Palët do të bashkëpunojnë për të arritur objektivin e vazhdimit të zhvillimit të versioneve të lokalizuara të Microsoft Office dhe Microsoft Windows.

e) Programet shtesë. Në varësi të mjedisit për zhvillimin e ICT-së në Shqipëri, Microsoft mund të konsiderojë futjen e programeve shtesë.

ë) Nismat e qeverisjes elektronike. Microsoft dhe qeveria kanë për qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga qeveria dhe organet dhe organizatat e tjera qeveritare për qytetarët. Për të punuar me këtë, si dhe me profile të tjera të avancuara të projekteve ICT, Microsoft së bashku me partnerët e certifikuar, do të shqyrtojë mundësinë e ofrimit të ndihmës së specializuar për qeverinë. Kushtet përcaktohen në Deklaratën e Shërbimeve të Microsoft-it, e cila është pjesë e marrëveshjes së biznesit dhe shërbimeve të Microsoft, në përputhje me seksionin 9.3 të kësaj marrëveshjeje.

3.2 Mbështetja e Microsoft në sektorin arsimor

1. Licencat në sektorin arsimor. Marrëveshjet e licencimit në sektorin akademik të Microsoft-it hartohen posaçërisht për trajtimin e nevojave dhe kërkesave në sektorin arsimor. MIOL do të vazhdojë të ofrojë për institucionet arsimore që janë përdorues të legjitimuar arsimorë, sipas kushteve të programit përkatës që është pjesë e programit të zgjedhjes së studentëve të Microsoft-it dhe programit të Microsoft për kampuset dhe shkollat, për të licencuar licenca për softuerë të përzgjedhur, me ulje të çmimit dhe rritje të nivelit të arsimimit.

2. Microsoft Live@edu. Qeveria mund të jetë pjesë e programit Microsoft Live@edu që do t'u ofrojë institucioneve të ligjshme të përcaktuara nga qeveria, si për shembull shkollat dhe universitetet, të drejta hyrjeje në shërbimet në rrjet të Microsoft-it, të quajtura Microsoft Live@edu. Këto shërbime përfshijnë posta elektronike personale falas për çdo student (Outlook Live e-mail), adresa internet personale blogging falas, shërbime bashkëpunimi dhe kapacitet 25GB për të ruajtur informacione në rrjet, si dhe shkarkim softuerë-sh falas për studentët dhe mësuesit. Kushtet e përdorimit të Live@edu do të pranohen gjatë regjistrimit në online e-mail domain nga MoE/Schools/Universities në <http://www.microsoft.com/liveatedu>.

3. Microsoft Dream Spark. Microsoft do të ofrojë nëpërmjet Live@edu për shkollat/universitetet/Ministrinë e Arsimit pjesëmarrjen në programin Microsoft Dream Spark, që ofron përdorim falas të mjeteve të projektimit dhe disenjimit të Microsoft për studentët e verifikuar, për të ndihmuar në edukimin dhe aftësimin e tyre nëpërmjet projektimit teknik, teknologjisë, matematikës, shkencave dhe aktiviteteve inxhinierike. Ky program u ofron zhvilluesve të së nesërme, projektuesve dhe profesionistëve të IT-së, mjetet profesionale për përdorim shtëpiak.

a) Gjatë afatit të kësaj marrëveshjeje, Microsoft do të punojë së bashku me qeverinë dhe palë të treta të interesuara (Lidera globalë në tregun e ICT-së) për ngritjen dhe hapjen e Qendrës Inovatore të Biznesit në Shqipëri, të cilat do të kontribuojnë në fuqizimin e biznesit vendas të ICT. Elementet specifike të Qendrës Inovatore të Biznesit do të përcaktohen në një marrëveshje të veçantë të lidhur ndërmjet Microsoft Corporation, Qeverisë Shqiptare dhe palëve të tjera të treta (në rast se ka).

b) Gjatë afatit të kësaj marrëveshjeje, Microsoft do të punojë së bashku me qeverinë dhe palë të treta të interesuara, për të projektuar dhe promovuar një nismë për Programin

Kombëtar PC me kosto të ulët, me qëllimin për t'i ofruar Sistemit Arsimor Shqiptar PC me çmim të përballueshëm për t'u përdorur vetëm për qëllime arsimimi.

c) Microsoft do të vërë në dispozicion programin Microsoft IT Academy në interes të institucioneve shqiptare të arsimit të lartë dhe do të mbështesë programet trajnuese për mësues duke vënë në dispozicion kurrikula të përshtatshme.

4. MBËSHTETJA E MICROSOFT PËR SEKTORIN PRIVAT

1. Ndërtimi i kapaciteteve. Microsoft do të ofrojë mbështetje në zhvillimin e biznesit dhe në ndërtimin e kapaciteteve, për t'iu dhënë mundësinë partnerëve të vet të certifikuar të arrijnë një nivel cilësie të krahasueshme me standardet e industrisë, sipas kushteve për të cilat do të bihet dakord me secilin prej partnerëve të certifikuar.

2. Eventet e mbajtura rregullisht. Microsoft do të organizojë me mbështetjen e partnerëve të certifikuar dy evente në vit gjatë afatit të kësaj marrëveshjeje, me fokus informimin mbi praktikën dhe/ose ekspertizën më të mirë të ITC-së, për shembull duke organizuar një ditë inovacioni, tryeza të rrumbullakëta ndërvepruese ose evente të ngjashme.

5. NISMAT DHE DETYRIMET E QEVERISË

Qeveria do të ndihmojë në nxitjen e zhvillimit të industrisë moderne të ICT-së në Republikën e Shqipërisë sipas përshkrimit të mëposhtëm.

5.1. Pajtueshmëri dhe zbatim të ligjeve të BE-së, OBT-së dhe të Shqipërisë. Qeveria bie dakord të sigurojë, brenda kompetencave dhe tagrave të veta kushtetuese dhe legislative, mbrojtje të plotë dhe efektive të të drejtave të pronësisë intelektuale brenda Republikës. Microsoft do të ofrojë ekspertë ligjorë falas për të këshilluar mbi marrjen e hapave të nevojshme për të siguruar pajtueshmëri efektive, legislative dhe zbatim të udhëzimeve të BE-së dhe OBT-së, si dhe zbatim të plotë të ligjeve që mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale. Kjo do të inkurajojë zhvillimin e industrisë vendase të softuerë-ve, e cila hap vende pune dhe sjell të ardhura. Duke marrë në konsideratë problemet serioze të piraterisë së softuerë-ve në Republikë, një mesazh i fuqishëm i dhënë nga qeveria për përdorimin e duhur të softuerë-ve është mjaft i rëndësishëm. Microsoft do të ndihmojë qeverinë në përpjekjet e saj për ndërgjegjësimin publik.

5.2 Zbatimi i procedurave për administrimin e aseteve të softuerë-ve. Qeveria do të zbatojë procedura efektive për administrimin e aseteve të softuerë-ve për të siguruar që brenda qeverisë, si dhe të gjitha institucioneve dhe organizatave të tjera qeveritare të përdoren vetëm softuerë të licencuar rregullisht. Qeveria do të shërbejë si model për organet vendore në Republikë për administrimin e aseteve të softuerë-ve. Microsoft do të ndihmojë qeverinë me zhvillimin dhe zbatimin e procedurave për administrimin e aseteve të softuerë-ve që do të fillojnë me një inventar të të gjithë softuerë-ve të përdorur nga qeveria. Procesi do të ndihmojë për të konstatuar shtesat e mëtejshme që mund të jenë bërë në inventarin e softuerë-ve të qeverisë dhe do të ndihmojë në administrimin dhe përmirësimin e softuerë-ve, në mënyrë që të sigurojë se po përdoren dhe po paguhet për softuerë-t më eficientë dhe më të nevojshëm.

5.3 Roli i qeverisë. Qeveria do të bëjë përpjekjet maksimale për të shërbyer si shembull dhe për të promovuar vetëm përdorimin e softuerë-ve të licencuar rregullisht, në sektorin arsimor, si dhe atë privat në Republikë.

5.4 Inspektimet. Qeveria do të angazhojë Inspektoratin Tregtar Shtetëror për të bërë inspekte dhe për të sekuestruar mallra që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale.

Qeveria do të marrë përsipër të trajtojë inspektorë gjyqësorë, policorë dhe tregtarë për t'i aftësuar në konstatimin e shkeljeve të të drejtave mbi pronësinë intelektuale dhe për të marrë masa efektive për të parandaluar shkelësit që të përfitojnë nga shkeljet, si dhe për të parandaluar shkelje të mëtejshme. Microsoft do të ndihmojë qeverinë në realizimin e trajnimit të lartpërmendur.

5.5. Fushatat publike. Qeveria dhe Microsoft do të ndërmarrin një fushatë publike për të informuar qytetarët dhe bizneset mbi ligjet dhe rregulloret e tjera për të drejtat mbi pronësinë intelektuale dhe ndikimin e shkeljeve të të drejtave mbi pronësinë intelektuale.

6. AFATI

Marrëveshja e Partneritetit Strategjik lidhet për një afat trevjeçar duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga të gjitha palët dhe ratifikimit të saj nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

7. PERSONAT E KONTAKTIT.

Palët në këtë marrëveshje caktojnë personat e mëposhtëm si persona kryesorë kontakti në kuadër të kësaj marrëveshjeje:

Qeveria: Endri Hasa, Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Microsoft: Arsen Kurti, menaxher vendor, Microsoft Albania sh.p.k.

7.2 Kompetencat e personave të kontaktit. Personat e caktuar të kontaktit nuk do të kenë të drejtë të lëshojnë dhe pranojnë deklarata me efekte detyruese mbi secilën nga palët. Përgjegjësia e personave të kontaktit është që t'i transferojnë në kohë çdo deklaratë marrësit të duhur, p.sh. MIOL. Secila nga palët do të ketë të drejtë të zëvendësojë personin e kontaktit me një person tjetër të përshtatshëm duke njoftuar palën tjetër me shkrim.

7.3 Njoftimet. Njoftimet dhe komunikimet e tjera ndërmjet personave të kontaktit do të kryhen me shkrim, me e-mail, me faks, me postë të regjistruar ekspres ose në forma të tjera me shkrim për të siguruar prova të besueshme me shkrim. Njoftimet do të konsiderohen si të dërguara në datën e shënuar në lajmërimin e marrjes në dorëzim ose në konfirmimin e marrjes së faksit ose mesazhit të postës elektronike ose në korrier.

8. KONFIDENCIALITETI

8.1 Konfidencialiteti. Secila nga palët mund të bëjë publike ekzistencën e kësaj marrëveshjeje, pasi ajo të jetë nënshkruar nga të gjitha palët. Gjithashtu, secila nga palët mund të publikojë edhe kushtet e kësaj marrëveshjeje. Përpara nënshkrimit të saj, informimi mbi kushtet e kësaj marrëveshjeje do të kufizohet vetëm tek ata zyrtarë qeveritarë, punonjës, kontraktorë dhe persona të tjerë që kanë lidhje me të, dhe vetëm në masën e nevojshme që duhet për miratimin apo zbatimin e marrëveshjes. Secili prej këtyre personave gjithashtu do t'u nënshtrohet detyrimeve për ruajtjen e konfidencialitetit në lidhje me këtë informacion. Qeveria do të sigurojë që këtyre personave t'u ngarkohet detyrimi për mospërhapje të informacionit.

8.2 Kohëzgjatja. Detyrimi i mësipërm i konfidencialitetit do të mbetet i vlefshëm edhe pas mbarimit të afatit ose përfundimit të kësaj marrëveshjeje, pavarësisht arsyes për zgjidhjen e saj.

9. TË NDRYSHME

9.1. Performanca dhe kohëzgjatja. Angazhimet e marra nga secila nga palët në këtë marrëveshje varen nga përmbushja e angazhimeve të palës tjetër. Qeveria konfirmon dhe pranon se Microsoft do të përmbushë shumë prej detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja nëpërmjet partnerëve lokalë. Palët do të fillojnë të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga

marrëveshja sapo ajo të hyjë në fuqi.

9.2 Gjuha. Kjo marrëveshje do të nënshkruhet në 6 kopje, secila në anglisht dhe shqip. Versionet në të dyja gjuhët përmbajnë të njëjtat terma dhe kushte. Për qëllime të interpretimit të kësaj marrëveshjeje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

9.3 Mungesa e ekskluzivitetit. Bashkëpunimi ndërmjet palëve sipas kësaj marrëveshjeje nuk do të jetë ekskluziv. Secila nga palët do të ketë të drejtën të lidhë kontrata të ngjashme me palë të treta. Palët pranojnë se qeveria ka dhe do të ketë të drejtën për të siguruar produkte dhe/ose shërbime softeri nga shitës të tjerë, përveç Microsoft dhe filialeve të tij.

Palët konfirmojnë dhe bien dakord se në rast se do të ketë marrëveshje tregtare vijuese, p.sh. licencimi apo shërbimesh, kjo do të vendoset me marrëveshje të veçantë ndërmjet palëve ose (në rast të licencave) me subjektin përkatës të Microsoft-it, i cili është i autorizuar të licencojë produkte të Microsoft në Shqipëri, dhe do të hartohen në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje dhe do të jenë në përputhje me ligjet e zbatueshme lokale të prokurimit.

9.4 Ndryshimet. Çdo ndryshim apo modifikim i kësaj marrëveshjeje duhet bërë me shkrim. Gjithashtu, kjo zbatohet edhe për ndryshime apo modifikime të kësaj kërkesë të formës me shkrim.

9.5 Pavlefshmëria e pjesshme. Në rast se një apo disa prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje shpallen të pavlefshme apo të pazbatueshme tërësisht apo pjesërisht, dispozitat e tjera të kësaj marrëveshjeje do të vazhdojnë të mbeten në fuqi. Dispozita e pavlefshme apo e pazbatueshme do të zëvendësohet me një dispozitë të vlefshme dhe të zbatueshme e cila i përafrohet qëllimit fillestar të palëve.

9.6 Ligji i zbatueshëm, juridiksioni. Kjo marrëveshje do t'u nënshtrohet ligjeve të Republikës së Irlandës. Gjykata e Republikës së Irlandës do të ketë juridiksionin ekskluziv për çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo marrëveshje.

9.7 Forca madhore. Vonesat apo mospërmbushja e detyrimeve nuk do të konsiderohen si shkelje e kësaj marrëveshjeje, në rast se kanë ardhur si rezultat i shkaqeve përtej kontrollit të arsyeshëm të palëve të ngarkuara me këto detyra dhe jo prej neglizhencës së tyre, duke përfshirë, por pa u kufizuar në zjarre, përmbajtje, aksidente, shpërthime, varfëri, forca të natyrës ("Forca madhore"). Pala që ngre pretendimin për rastin e forcës madhore, duhet të njoftojë palën tjetër, me shkrim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga ngjarja e forcës madhore, duke përcaktuar natyrën dhe një parashikim për kohëzgjatjen e vonesës. Palët do të bëjnë përpjekje maksimale për të shmangur ose minimizuar ndikimet që mund të vijnë nga vonesa apo mospërmbushja e detyrimeve.

9.8. Interpretimi. Çdo dykuptimësi në këtë marrëveshje do të interpretohet me paanshmëri, pa marrë parasysh se cila nga palët e ka hartuar marrëveshjen apo cilëndo dispozitë të saj.

9.9 Marrëveshja në tërësi. Kjo marrëveshje do të përbëjë çdo gjë për të cilën është rënë dakord, si dhe marrëveshjen ndërmjet palëve për sa i përket objektit të kësaj çështjeje dhe zëvendëson çdo diskutim, marrëveshje, mirëkuptim apo deklaram të mëparshëm, qoftë verbal apo i shkruar dhe qoftë apo jo i nënshkruar nga palët.

Në dëshmi të kësaj, palët i kanë bërë përfaqësuesit e tyre të autorizuar që ta nënshkruajnë këtë marrëveshje në datën e hyrjes së saj në fuqi.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë:	Në dëshmi të:	MICROSOFT:
Nënshkrimi	Nënshkrimi	Nënshkrimi
Emri	Emri	Emri
Genc Pollo	Jan Muehlfeit	Arsen Kurti
Titulli	Titulli	Titulli
Ministër i Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit	Drejtor për Europën, Microsoft	Menaxher vendor, Microsoft Albania
Data e nënshkrimit	Data e nënshkrimit	Data e nënshkrimit
15.6.2010	15.6.2010	15.6.2010